



---

**“ILLYRIAN GUARD” SH.A**

**Miratohet**

**ADMINISTRATORI**

**Anduel Xhindi**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCES VERBAL datë \_\_.\_\_.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

- **OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale Promocionale”**
- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
79800000-2-Printime dhe shërbime të lidhura**
- **VLERA E FONDIT LIMIT: 1,594,006** (Një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtë ) **LEK PA TVSH**
- Sigurimi i ofertës 2% 31,880 fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të urdhërit të prokurimit Nr. 1444/ 17.11.2023, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: “**Materiale Promocionale**” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A ju informojmë për sa më poshtë:

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit të propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të fondit limit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një

nga këto 2 vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

**2.2.2.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësor. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar Nenit 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

*Përsa i përket kapacitetit teknik, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme:*

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 2 viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë 2 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku

te shenohen, vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe/ose fatura tatimore te shitjes, tw plotwsuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK

**2.3.2.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

**ISO 9001:2015** çertifikatën e menaxhimit të cilësisë së punimeve; ose ekuivalente.

**ISO 14001:2015** për sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akredituar.

**Argumentim:** Nisur nga proceset e punes kritike, rendesise se sistemit dhe sherbimeve qe ai ofron, gjykohet e aryeshme qe operatori ekonomik proceset e punes se tij, ti bazoje ne standarde boterore, te cilat ne menyre direkte ndikojne ne cilesi, shpejtesi, efikasitet dhe te sherbimeve te ofruara. Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria. : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.3.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në staf të paktën 1 punonjës, si dizenjator dekorator, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik listëpagesat

ku të figurojë me kodin përkatës, te regjistruar te paktën muajin e fundit, si dhe kontrata e punës. Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Argumentim :** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

**2.3.4.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në staf të paktën 2 punonjës si montues bordesh në reklama, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik listëpagesat ku të figurojë me kodin përkatës, te regjistruar te paktën muajin e fundit ,si dhe kontrata e punës. Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Argumentim :** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

**2.3.5.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme, për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

- a. Sharrë për prerje elementësh për tabelat, 1 copë.
- b. Ploter dixhital për stampimin e reklamave, 1 copë.
- c. Printer për dizenjimin e reklamave, 1 copë.
- d. Makineri prerëse për adezivat për tabelat reklamuese, 1 copë.
- e. Frezë, për prerjen e elementëve për prodhimin e tabelave, 1 copë.
- f. Lazer për prerjen e pleksi glass, metaleve, për shkrime adezive, 1 copë.

Për mjetet/pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e mjeteve/pajisjeve, kontrata, ose akt çdoganimi, ose fatura tatimore përkatëse, si dhe fotot e tyre, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik dhe para lidhjes së kontratës.

**Argumentimi:** Ky kriter jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funktionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

**Argumentim:** Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t’i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektsh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të përcaktojë se afatet e levrimin duhet të jenë sipas afateteve të përcaktuara nga AK, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës .

**Argumentim:** Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e montimit si dhe vendosjen nëpër vende/objekt të artikujve të përmendur në Tabelën e mëposhtme. (Tabela 1)

Tabela 1

Nr	Rrethi	Menyra e levrimin.
1	Durrës	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
2	Elbasan	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
3	Korce	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
4	Vlore	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
5	Fier	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)

6	Lezhe	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
7	Gjirokaster	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
8	Berat	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
9	Diber	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)
10	Kukes	F.V Tabela identifikuese (plexi glass)

**Argumentim:** Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Njesia e prokurimit:**